

Në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.22/2024), nenit 12 paragrafi 2 pika d), nenit 52 dhe nenit 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 13 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e katërt të rregullt, e mbajtur më datën 29.04.2025, merr këtë:

VENDIM NR.22/2025/KG

për bartjen e të hyrave të pashpenzuara vetanake të komunës nga viti 2024 në vitin 2025

Neni 1

Miratohet vendimi për bartjen e të hyrave të pashpenzuara vetanake të komunës nga viti 2024 në vitin 2025 në një shumë të përgjithshme prej **566,326.81€**.

Neni 2

Në kategorinë e shpenzimeve **Mallra dhe shërbime** të bartet shuma prej **32.146,68€** në Kodin e programit: **163** Administrata dhe personeli Nën-programi: **16308** Administrata

Në kategorinë e shpenzimeve **Shpenzime komunale** të bartet shuma prej **34.861,75€** në Kodin e programit: **163** Administrata dhe personeli Nën-programi: **16308** Administrata

Në kategorinë e shpenzimeve **Subvencione dhe transfere** të bartet shuma prej **25.720,85 €** në Kodin e programit: **160** Zyra e kryetarit Nën-programi: **16008** Zyra e kryetarit

Në kategorinë e shpenzimeve **Investime kapitale** të bartet shuma totale prej **473,597.53€** në nën-programe dhe projekte të mëposhtme:

Në programin **163 Administrata dhe personeli** dhe nën-programi **16308 Administrata dhe personeli** të bartet shuma prej **97,966.33€** në projektet e mëposhtme:

- Që në kodin e projektit **51668 Rekonstruktimi i ndertesës së administratës së komunës** të bartet shuma prej **10,000,00€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **89464 Bashkëfinancimi i projekteve me donatorë potencial** të bartet shuma prej **87,966,33€** si projekt i vjetër.

Në programin **180 Shërbime publike** dhe nën-programi **18008 Infrastruktura rrugore** të bartet shuma prej **125,000.00€** në projektet e mëposhtme:

- Që në kodin e projektit **53657 Ndriçimi publik në vendbanimet: Graçanicë, Llapllasellë, Çagllavicë, Preoc, Badovc, Uglar, Kishnicë dhe Sushicë** të bartet shuma prej **20,000.00€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **53682 Ndriçimi publik në vendbanimet: Batushë, Radevë, Lepinë, Skullan, Suhadoll, Lagje e Re, Dobrotin, Gushtericë e Poshtme dhe te Epërme dhe Livagjë** të bartet shuma prej **20,000.00€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **53685 Ndërtimi dhe rindërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në vendbanimet: Graçanicë, Llapllasellë, Çagllavicë, Preoc, Badovc, Uglar, Kishnicë dhe Sushicë** të bartet shuma prej **30,000.00€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **54737 Rregullimi i hapësirave publike dhe parqeve në vendbanimet: Skullan, Gushtericë e Poshtme, Gushtericë e Epërme, Kishnicë, Livagjë dhe Çagllavicë** të bartet shuma prej **20,000.00€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **54742 Rikonstruktimi i varrezave dhe objekteve ndihmës në vendbanimet: Dobrotin, Gushtericë e Poshtme, Badovc dhe Graçanicë** të bartet shuma prej **35,000.00€** si projekt i vjetër.

Në programin **660 Planifikimi urban** dhe nën-programi **66345 Planifikimi urban** të bartet shuma prej **250,631.20€** në projektet e mëposhtme:


- Që në kodin e projektit **53573 Asfaltimi i rrugëve në Graçanicë, Sushicë, Llapllasellë, Badovc, Kishnicë, Çagllavicë dhe Preoc** të bartet shuma prej **173,561.52€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **53643 Ndërtimi i objekteve ndihmëse dhe shoqëruese në varrezat në Graçanicë dhe Llapllasellë dhe shpronësimi i tokës** të bartet shuma prej **57,069.68€** si projekt i vjetër.
- Që në kodin e projektit **54768 Rregullimi i këndëve të lojërave për fëmijë në Graçanicë, Llapllasellë, Sushicë, Dobrotin, Radevë, Lepinë dhe Batushë** të bartet shuma prej **20,000.00€** si projekt i vjetër.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi janë përgjegjës: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.,

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Graçanicës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević

